REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. i vendimit 1017

1017

# V E N D I M

## PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot në datë 21. 1.1994 unë Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, pasi shqyrtova materialet e paraqitura dhe kërkesën e zotërinjëve Nazmi Dauti, Mehmet Kastratidhe Gëzim Cura per të rregjistruar shoqërinë e tyre me pergjegjësi te kufizuar si person juridik

## K O N S T A T O V A  S E

Kërkuesit Nazmi Dauti, Mehmet Kastrati dhe Gëzim Cura kanë paraqitur kërkesën e tyre per të rregjistruar shoqërinë e tyre me pergjegjesi të kufizuar te quajtur "Progres" si person juridik. aktiviteti që do të zhvillojë kjo shoqëri është: Veprimtari ndertuese si punime dheu, muraturë betoni,ndertime civile,industriale, turistike,bujqesore, instalime në to,punime restaurimi,transport brenda dhe jashtë vendit,tregti makinash, pjese kembimi te tyre me shumicë dhe pakicë, import eksport.
Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillé duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Dhe në mbështetje të ligjit nr. 7667 date 28.1.1993

## V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te Shoqerisë me Përgjegjësi te Kufizuar "PROGRES"shPK per te ushtruar veprimtari private në fushën e veprimtarisë ndertuese si punime dheu, muraturë betoni, ndertime civile,industriale, turistike, bujqesore, instalime ne to,punime restaurimi,transport brenda dhe jashtë vendit, tregti makinash, pjesë kembimi të tyre, me shumice dhe pakice, import eksport.
Kunder ketij vendimi behet ankim ne shkallen e dytë.
Tirane, më 1994

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. i vendimit 1017

# V E N D I M

## PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot në date 21. 1.1994 unë Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova materialet e paraqitura dhe kërkesën e sotërinjeve Nazmi Dauti, Mehmet Kastratidhe Gëzim Cura per të rregjistruar shoqerine e tyre me përgjegjësi të kufizuar si person juridik

## K O N S T A T O V A  S E

Kërkuesit Nazmi Dauti, Mehmet Kastrati dhe Gëzim Cura kanë paraqitur kërkesën e tyre për të rregjistruar shoqerine e tyre me përgjegjësi të kufizuar te quajtur "Progres" si person juridik. Aktiviteti që do të zhvilloje kjo shoqëri është: Veprimtari ndertuese si punime dheu, muraturë betoni,ndertime civile,industriale, turistike,bujqesore, instalime në to,punime restaurimi,transport brenda dhe jashtë vendit,tregti makinash, pjese këmbimi te tyre me shumicë dhe pakicë, import eksport.
Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

## PER KETO ARESYE

Dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7667 date 28.1.1993

## V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "PROGRES"SHPK per te ushtruar veprimtari private në fushën e veprimtarisë ndertuese si punime dheu, muraturë betoni, ndertime civile,industriale, turistike, bujqesore, instalime në to,punime restaurimi,transport brenda dhe jashtë vendit, tregti makinash, pjesë këmbimi te tyre, me shumice dhe pakicë, import eksport.
Kunder këtij vendimi bëhet ankim në shkallë të dytë.
Tirane, më 1994

GJYQTARE
Donika Deti

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. i vendimit 1017

# V E N D I M

## PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot ne date 21. 1.1994 une Gjyqtarja e Gjykates se Rr... hit Tirane, pasi shqyrtova materialet e paraqitura dhe ke... esen e zoterinjeve Nazmi Dauti, Mehmet Kastratidhe Gezim C... a per te rregjistruar shoqerine e tyre me pergjegjesi t... kufizuar si person juridik

## K O N S T A T O V A   S E

Kerkuesit Nazmi Dauti, Mahmet Kastrati dhe Gezim Cur... kane paraqitur kerkesen e tyre per te rregjistruar shoqerine e tyre me pergjeggesi te kufizuar te quajt... "Progres" si person juridik. Aktiviteti qe do te zhvil... je kjo shoqeri eshte: Veprimtari ndertuese si punime dheu, ... rature betoni, ndertime civile, industriale, turistike, bujqeso... , instalime ne to, punime restaurimi, transport brenda dh... jashte vendit, tregti makinash, pjese kembimi te tyre me shumice dhe pakice, import eksport.
Kerkesa e paraqitur eshte e drejte dhe e bazuar ne li... dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARESYE

Dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7667 date 28.1.1993

## V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridike te Shqoerise me Per... gjjesi te Kufizuar "PROGRES"SHPK per te ushtruar veprimtar... private ne fushen e veprimtarise ndertuese si punim... dheu, murature betoni, ndertime civile, industriale, turist... e, bujqesore, instalime ne to, punime restaurimi, transpo... brenda dhe jashte vendit, tregti makinash, pjese kem... bi te tyre, me shumice dhe pakice, import eksport.
Kunder ketij vendim... ... ankim ne shkalle te dyte.
Tirane, me 19...                GJYQTA...

Verbal ... 83 09-01-95

## V E N D I M

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHQQERISE "PROGRES" sh.p.k

Sot me date 27.11.1995,u mblodh ne Tirane ,asambleja e ortakeve te shoqerise "PROGRES" sh.p.k.

Mbledhja u zhvillua ne seline kesaj shoqerie me adrese ne rrugen "Mehmet Bega" nr.4 ne Tirane,nga ortaket e kesaj shoqerie me kuota perkatesisht Nazmi Dauti.me 33% te kapitalit,Mehmet Kastrati me 34% dhe Gezim Cura me 33%.

Pas leximit dhe miratimit te rendit te dites u diskutua per prishjen dhe venien ne likuidim te shoqerise "Progres"sh.p.k,si dhe per caktimin e likuidatorit .

Ne perfundim te diskutimeve ortaket e shoqerise rane dakord qe te prishin shoqerine e siperpermendur ,per arsye se kjo nuk ka pasur rezultate dhe nuk mund te zhvilloje me aktivitetin e saj per aresye objektive. Me renien dakord te prishjes se shoqerise nga asambleja e jashtezakonshme e ortakeve u vendos dhe caktimi i likuidatorit z.Robert Mancellari,i cili do te vere ne likuidim kete shoqeri.

Pas miratimit te mesiperm asambleja e jashtezakonshme e ortakeve doli me vendimin perkates.

O R T A K E T E S H O Q E R I S E

" PROGRES " SH.P.K

| NAZMI DAUTI | MEHMET KASTRATI | GEZIM CURA |
|---|---|---|

REPUBLIKA E SHQIPERISE — Nr. 6281 rep.

DHOMA E NOTERISE TIRANE — Nr. 2170 kol.

## V E R T E T I M

Sot me date 04.12.1995,perpara meje Noteres u paraqiten personalisht palet : 1.Mehmet Kastrati me nr. te leternjoftimit EV204620,dhe 2.Nazmi Dauti me nr te leternjoftimit QH290201,me cilesite e ortakut te shoqerise "Progres" sh.p.k si dhe me cilesine e perfaqesuesit me prokure te pergjithshme dhe te drejte per te firmosur te leshuar nga ortaku Gezim Cura te vertetuar nga notere Zeqine Sina me nr. kol.601 dhe te rep.1380 me dt.1.02.1995

ne emer te te siperpermendurit ortakut Nazmi Dauti,te cilet deklaruan se sa me siper eshte nje vendim i asamblese se kesaj shoqerie i marre me vullnet te lire dhe te plote te tyre jashte kesaj zyre,dhe une noterja e vertetoj rregullisht.

N O T E R E

Violeta Frashëri

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

N. 1017/1 aktit,

## V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 12.5 1996,une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane [signature] mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Nazmi Dauti me cilesine e administratorit te shoqerise "Progres "sh.pk qe ben fjale per ndryshimet perkatese dhe depozitimin e tyre ne Gjykate.

## K O N S T A T O V A

Se kerkuesi kerkon depozitimin prane kesaj Gjykate te kerkeses ,vendimit te asamblese se jashtezakonshe te ortakeve te shoqerise "Progres"sh.p.k si dhe te kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit themeltar ku behet fjale per shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise nga ana e dy ortakeve te kesaj shoqerie Nazmi Dauti me 34.000 leke dhe Mehmet Kastrati me 33.000 leke ,te cilet ia kane shitur kuotat e tyre te mesiperme te kapitalit ortakut tjeter te shoqerise Gezim Curi ,dhe ne baze te vendimit te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie e cila eshte regjistruar ne Gjykaten e rrethi t Tirane me dt.21.1.1994 me nr.1017.Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.Gjithashtu ne kerkese behet fjale per ndryshimin e selise se shoqerise "Progres" sh.p.k nga selia aktuale e ndodhur ne Tirane ne rr."Mehmet Bega" ne seline e re ne Perrenjas ne lagjen nr.1 ,pall22,si dhe per ndryshimin e administratorit te kesaj shoqerie nga Nazmi Dauti ne administratorin e ri Gezim Cura.

Kerkesa e kerkuesit eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit 7638 te dt.19.11.1992 per shoqerite tregtare dhe te ligjit Nr.7667 te dt.28.01.1993 per regjistrin tregtar.

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses dhe te vendimit te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "PROgres"sh.p.k ,peraa i perket shitjes shitjes dhe transferimit te kuotave te kapitalit themeltar te dy ortakeve te kesaj shoqerie Nazmi Dauti me 34.000 leke dhe Mehmet Kastrati me 33.000 leke ortakut tjeter te kesaj shoqerie z.Gezim Cura,i cili ngelet probar i vetem i kapitalit te shoqerise qe eshte 100.000 leke,ndryshimit te selise nga ajo aktuale ne Tirane ne rr."Mehmet Bega" Nr.4,ne seline e re ne Perrenjas ne L.1,pall.22,si dhe per ndryshimin e administratorit nga z.Nazmi Dauti ne administratorin e ri z. Gezim Cura,duke bere ndryshimete mesiperme

PULLE TAKSE

MIRANDA XHEMALCE
NOTERE
TEL 262 84
TIRANE

## V E N D I M

**I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE "PROGRES" sh.p.k**

Sot me date 8.1.1996,u mblodh ne Tirane ,asambleja e jashtezakonshme e shoqerise "PROGRES" sh.p.k .Mbledhja u zhvillua ne seline e kesaj shoqerie ne Tirane ne rr."Mehmet Bega" nr.4.Pas leximit dhe miratimit te rendit te dites u diskutua per ndryshimet e meposhteme:

1. Dy ortaket e shoqerise "PROGRES"sh.pk ,Nazmi Dauti dhe Mehmet Kastrati ,me vullnetin e tyre te lire dhe te plote vendosen te largohen nga kjo shoqeri duke ia shitur kuotat e tyre te kapitalit te kesaj shoqerie perkatesisht Nazmi Dauti kuoten e tij prej 34.000 lekesh, Mehmet Kastrati kuoten e tij prej 33.000 lekesh ,ortakut tjeter te kesaj shoqerie zotit Gezim Cura,i cili i pranoi ti bleje ato duke u bere pronar i te gjithe kapitalit te shoqerise qe eshte 100.000 leke.
2. Ndryshimin e selisese shoqerise "PROGRES" sh.p.k nga selia aktuale ne Tirane ne rr."Mehmet Bega" nr.4 ne seline e re ne Perrenjas ne lagjen nr.1,pall.22.
3. Ndryshimin e administratorit te kesaj shoqerie nga administratori aktual Nazmi Dauti ne emerimin e administratorit te ri z.Gezim Cura .

Pas miratimit te ketyre ndryshimeve ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe me statutin e shoqerise asambleja e ortakeve doli me vendimin perkates ,duke ngarkuar administratorin e kesaj shoqerie qe se bashku me dokumentacionin e nevojshem te beje depositimin e tyre prane Gjykates se rrethit Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE "PROGRES" SH.P.K

| NAZMI DAUTI | MEHMET KASTRATI | GEZIM CURA |
|---|---|---|

REPUBLIKA E SHQIPERISE Nr. 300 rep.
DHOMA E NOTERISE TIRANE Nr. 45 kol.

## V E R T E T I M

Sot me date 1996,perpara meje Noteres ne dhomen e Noterise ne Tirane u paraqiten personalisht ortaket e shoqerise "PROGRES"sh.p.k Nazmi Dauti,Mehmet Kastrati dhe Gezim Cura,qe te tre madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se sa me siper eshte nje vendim i marre prej tyre me vullnet te lire dhe te plote.Une Noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

**AKT - THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "PROGRES"**

Sot më datën 19.01..1994 (nëntëdhjetëekatër) ditën ______ u paraqitën konstituentë

1. Nazmi Dauti, i biri i Abdullait dhe i Kudies datëlindja 9.8.1940, banues në Tiranë, Rr."Qemal Stafa", pallati 587, shk.III, ap.7.

2. Mehmet Kastrati, i biri i Shaqirit dhe Adlijes, datëlindja 5.3.1932

3. Gëzim Cura, i biri i Abdullait dhe i Dudies datëlindja 15.7.1966

të cilët u prezantuan nga paraqitja e letërnjoftimeve, janë madhore dhe kanë zotësi të plotë për të vepruar. Ata kërkuan akt themelimin.

Neni 1

Midis të lartpërmendurve u ra dakord, që të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar.

**Emërtimi** - "Progres" Shoqëri Ndërtimi

**Kohëzgjatje** - dhjetëvjet, duke filluar nga dita e marrjes së licensës nga organi kompetent.

**Vendi ku do të ushtrohet aktiviteti:** Në Tiranë e në qytete të tjera të vendit dhe jashtë shtetit. **Adresa e firmës : Mehmet Kastrati, Rr."Mehmet Bega", nr.4, Tiranë.**

**Kapitali:** Si kapital fillestar në dispozicion të shoqërisë vihet shuma l00000(njëqindmijë) lekësh e cila do të ndahet (investohet) nga ortakët si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| Nazmi Dauti investon shumën | 34000 (tridhjetëekatërmijë) | lekë |
| Mehmet Kastrati investon shumën | 33000 (tridhjetëetremijë) | lekë |
| Gëzim Cura investon shumën | 33000 (tridhjetëetremijë0 | lekë |

Depozitimi i kuotës së mësipërme nga ortakët do të bëhet menjëherë, domethënë që me marrjen e licencës, kohë të cilën do të fillojë aktiviteti i shoqërisë. Për depozitimin e shumave do të mbahet një proces verbal që do të nënshkruhet nga ortakët që do t'i bashkëngjitet dokumentacionit të shoqërisë.

Neni 2

**Objekti i vepirmtarisë** të shoqërisë do të jetë, kati i parë punime dheu , muraturë betoni , blarme të zakonshme, punime shembjesh, kati i dytë ndërtime civile, industriale, turistike , bujqësore etj. e kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Kati i tretë punime restaurimi.

Aktivitete në fushën e transportit brenda e jashtë vendit , karburateve të ndryshme, makina e pjesë këmbimi etj. me pakicë e shumicë import eksport.

Neni 3

Të ardhurat e realizuara nga ortakëria ,domethënë fitimi do të ndahet midis ortakëve si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Nazmi Dauti do të marrë | 33% të fitimit |
| Mehmet Kastrati do të marrë | 34% të fitimit |
| Gëzim Cura do të marrë | 33% të fitimit |

Neni 4

Administrator unik i kësaj shoqërie është zoti Nazmi Dauti dhe si ortakë Mehmet Kastrati dhe Gëzim Cura.

Neni 5

Përfaqësimi i Shoqërisë "Progres" si në marrëdhëniet kontraktuale dhe jokontraktuale me persona të tretë (fizikë e juridikë) në organet e administratës shtetërore (bashki, bankë, etj.) në arbitrazh dhe në organe të drejtësisë (në të gjithë sistemin gjyqësor) brenda dhe jashtë vendit do të bëhet nga administratori i shoqërisë z.Nazmi Dauti. Në mungesë të tij , këtë detyrë do ta kryejnë Mehmet Kastrati dhe Gëzim Cura. Në mungesë të tre zotërinjve të përmendur shoqëria mund të përfaqësohet nga një person tjetër , por kurdoherë ai duhet të pajiset me prokurë të posaçme. Për lehtësim të punëve dhe për të ndihmuar në aspekt të njohjes dhe zbatimit të ligjshmërisë shoqëria ka të drejtë të angazhojë dhe një avokat me të cilin mund të bëjë kontratë të veçantë.

Neni 6

Shoqëria ka të drejtë që për nevoja pune të marrë në punë punonjës me mëditje me të cilët në bazë të ligjit për marrëdhëniet e punës, për secilin do të redaktojë një kontratë të veçantë pune në të cilën duhet të parashikojë kushtet e punës, afatin, pagesën mujore , pushimin javor dhe vjetor etj.

Neni 7

Shoqëria ka të drejtë të hapë llogari rrjedhëse në Bankën Tregtare Tiranë dhe në banka të tjera, ku do të kryejë veprime likuidimi, arkëtim të ardhurash etj. Gjithashtu ajo ka të drejtë të anëtarësohet në Dhomën e Tregtisë Tiranë, duke paguar kuotën (detyrimin) përkatës vjetor.

*

* *

Duhet theksuar se veprimtaria e ortakërisë mbështetet në aktet ligjore, të miratura nga organi kompetent si dhe në dy dokumentet bazë të shoqëria, në aktin e themelimit (aktmarrëveshjen) dhe statutin, ku në këtë të fundit janë përcaktuar në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrat e ortakëve të këshillit të administrativ, organizimin e funksionimin e asamblesë së ortakëve , në bazë të të cilit do të organizohet veprimtaria praktike e shoqërisë.

Kjo akt marrëveshje u redaktua në tre kopje, njëra do të dorëzohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë ku vendoset regjistrimi si person juridik, një tjetër në zyrën e financës që ka në kompetencë lëshimin e licensës dhe tjetra mbahet në dokumentet e shoqërisë.

Aktmarrëveshja lexohet nga ortakët dhe pasi të gjithë shprehen dakord me përmbajtjen e saj e nënshkruajnë pa vërejtje e me vullnet të lirë

**Tiranë,më ____ 1994**

**O R T A K Ë T**

| | | |
|---|---|---|
| **Mehmet Kastrati** | **Nazmi Dauti** | **Gëzim Cura** |

REPUBLIKA E SHQ PËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË.
328
Nr. 53 Rep.
Ne. Ko. 1

## KONTRATË SHITJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Në Tiranë, sot më datën 12. 1.1996, para meje noteres publike ke Miranda Xhemalve u paraqitën personalisht dhe kërkuan përpilimin e kësaj kontrate shitjeje :

SHITËSIT : MEHMET KASTRATI, i biri i Shaqirit, i dtl. 1932, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar; nr. letërnjoftimi EV 204620.

NAZMI DAUTI, i biri Abdullait dhe i Kudies, i dtl. 1940, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr letërnjoftimi QH 290201.

BLERËSI: GËZIM CURRA, i biri i Abdullait dhe i Dudijes, i dtl. 1966, Prrenjas, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. letërnjoftimi QH 483904.

Me vendimin nr. 1017, datë 21.1.1994 të gjykatës së rrethit Tiranë, është krijuar shoqëria "Progres SHPK me ortak Mehmet Kastrati , Nazmi Dautin dhe Gëzim Currë, me kapital 100.000 lekë, me kuota përkatësisht Mehmeti 33000, Nazmiu 34000 dhe Gëzimi 33000 . Rezulton se kapitali ka mbetur pa ndryshuar.

Shitësat Mehmet Kastrati dhe Nazmi Dauti pjesën e tyre të kapitalit përkatësisht 33000 dhe 34000 lekë me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ja shesin ortakut tjetër të shoqërisë blerësit Gëzim Curra i cili i ka pranuar këto kapitale.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pronar i ligjshëm i kapitalit të shoqërisë "Progres"SHPK bëhet blerësi Gëzim Curra, mbi të cilin bien të drejtat dhe detyrimet .

Kjo kontratë përpilohet në tri kopje, u lexohet palëve nënshkruhet rregullisht prej tyre në prani të noteres dhe unë noterja duke parë vullnetin e tyre të lirë e të plotë e vërtetoj sipas ligjit,

SHITËSAT | BLERËSI

MEHMET KASTRATI NAZMI DAUTI | GËZIM CURRA

Gëzim Curra

PULLË TAKSE
R.SHQIPËRISË

MIRANDA XHEMALAJ
NOTERE
TEL 262...

NOTERE
TIRANË

# S T A T U T I

# PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TË "PROGRES"

## KREU I

## FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

### Neni 1

Shoqëria "PROGRES" ushtron aktivitetin privat në formën e ortakërisë me përgjegjësi të kufizuar, me ortakë:

1. Nazmi Dauti
2. Mehmet Kastrati
3. Gëzim Cura

### Neni 2

Shoqëria është person juridik shqiptar, e drejtë që fitohet nga dita e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

### Neni 3

Shoqëria "Progres" zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara me dokumentet e krijimit të saj.

### Neni 4

Selia e Shoqërisë "Progres" do të jetë në Tiranë, Rr."Mehmet Bega", nr.4.
Por Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me zgjerimin e aktivitetit .

### Neni 5

Shoqëria "PROGRES", ka të drejtë të blejë, të marrë me qira dhe të ndërtojë objekte të ndryshme që do të shërbejnë për punën normale të saj.

Objekti i veprimtarisë së ortakërisë do të jetë: ndërtimi i banesave private, institucioneve të ndryshme shtetërore, rikonstruksione, blerje e shitje të pajisjeve elektrike,pllakave të ndryshme, lavamanë të ndryshëm, vaska etj., karburante të llojeve të ndryshme, makina e pjesë këmbimi, aktivitete në fushën e transportit etj. Me pakicë e shumicë, import , eksport.

Neni 6

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar i përballon humbjet e saj deri në kufizimin e vlerës së kapitalit të investuar në të.

Neni 7

Shoqëria për detyrimet që ka ndaj të të tretëve do të përgjigjet me fondet e veta.

Neni 8

a. Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë.

b. Të marrë pjesë në rezultatet e çdo forme e sasie të veprimtarisë së shoqërisë, parashikuar në aktin e krijimit dhe të statutit.

c. Pjesëmarrjen me përfaqësim në të gjitha orgnet e shoqërisë.

d. Të marrë të dhëna për gjendjen ekonomike e financiare të shoqërisë, të njihet me të gjitha dokumentet ku evidentohet aktiviteti i saj.

dh. Të paraqesë propozimet dhe të shfaqë mendime në asamblenë e ortakëve dhe në këshillin administrativ të shoqërisë.

Neni 9

**<u>Ortakët kanë këto detyra:</u>**

a. Të depozitojnë kuotën për krijimin e kapitalit bazë dhe kuotën sublimentare , sipas vendimit të asamblesë së ortakëve.

b. T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme (ekonomike e financiare, dokumentare etj.) që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës.

c. Të kryejnë detyrat që caktohen nga Administratori unik ose nga asamblea e ortakërisë.

Neni 10

Secili ortak ka të drejtë të heqë dorë nga pjesëmarrja në Shoqëri, duke qenë i detyruar të njoftojë administratorin unik një muaj më parë dhe në të njëjtën kohë të paraqesë propozimin për shitjen e kuotës që ai ka në kapitalin bazë.

Heqja dorë e ortakut nuk e shkarkon atë nga detyrimet e mara më parë ndaj shoqërisë dhe nuk pengon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut që të heqë dorë nga pjesëmarrja në shoqërisë, për blerjen e kuotës së tij, atëherë ai ka të drejtë t'ia shesë personave të tretë, por me të njëjtat kushte që ua propozon ortakëve.

Neni 11

Për heqjen dorë nga veprimtaria e shoqërisë vendos Administratori unik, pasi më parë ka marrë edhe mendimin e ortakëve të tjerë.

## LIBRI I SHOQËRISË

Neni 12

**Marrëdhëniet ekonomike-financiare**

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në mbështetje të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

Për të precizuar e saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet : **LIBRI I SHOQËRISË.**

Neni 13

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose inicialet "SHPK", kapitalin dhe emrin e administratorit.

Neni 14

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë private, kapitali bazë është 100000 (njëqindmijë) lekë që përbën burimin fillestar për krijimin e kapitalit themelor të mjeteve të xhiros. Ortakët marrin pjesë në krijimin e kapitalit bazë, me kuotat e tyre, të cilat përcaktohen në aktin e krijimit të shoqërisë, ku është përcaktuar edhe mënyra e afati i arkëtimit të kuotës nga secili ortak. Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm.

Neni 15

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen detyrimet që ka ndaj të tretëve, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave ua ndanë ortakëve në përpjesëtim me kuotën e depozituar për krijimin e kapitalit bazë.

Neni 16

Shoqëria ka të drejtën e tjetërsimit, të disponimit dhe të përdorimit të pasurive të veta, në përputhje me qëllimet e objektivat e veprimtarisë që kryen, ajo gëzon të drejtën e mbrojtjes së pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 17

Shoqëria me fondet e veta ka të drejtë të kryejë lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike, tregtare, financiare apo shërbimi me persona juridikë shqiptarë dhe të huaj.

Përbërja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë e atij të veçantë, përdorimi dhe regullimi i tyre vendoset nga asamblea e ortakërisë. Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ose nga marrëdhëniet me të tretët, mbulohen me fondet rezervë e të veçantë, ose nga shumat e tjera suplimetare që mund të derdhin ortakët, në raport me kuotën e krijimit të tyre (kapitalet bazë) . Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, gjithashtu pjesët e kapitalit themeltar mund t'i transferohen të tretëve, me miratim të ortakut të vetëm. Gjithashtu ato janë lirisht të transferueshme , në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve si dhe trashëgimie.

Neni 18

Fitimi neto i shoqërisë ndahet sipas ortakëve në raport me përqindjen në pjesëmarrjen në kapitalin bazë.

Neni 19

Shoqërisë sipas mundësive që i krijohen ka të drejtë të investojë në ndërmarrje e shoqëri të tjera, qofshin këto private apo shtetërore, të disponojë aksione sipas dispozitave në fuqi.

Neni 20

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në bilancin e saj në vlerat e shprehura në monedha shqiptare dhe të huaja, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Bilanci i vitit të parë të veprimtarisë paraqitet brenda muajit prill dhe po kështu veprohet në bilancet vjetore të çdo viti. Forma e bilanceve dhe e llogarive caktohet nga asamblea e ortakëve duke vlerësuar kriteret e caktuara nga aktet ligjore.

Neni 21

Veprimtaria financiare e shoqërisë , mbështetet në pasivin e aktivin , shprehur në valutë të konvertueshme, llogaria kontabël dhe ekonomike mbahen në Shqipëri. Rezultatet finaciare të veprimtarisë së shoqërisë caktohen në bazë të bilancit vjetor.

Neni 22

Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë , rregullohen me kontrata të posaçme që do të lidhet me secilën, duke u bazuar në ligjin "Mbi marrëdhëniet e punës".

Neni 23

Pagat e punës caktohen nga administratori unik dhe nga këshilli administrativ në përputhje me treguesit ekonomik e financiar. Në përputhje me kushtet konkrete pagesa bëhet: me orë, ditore, mujore. Madhësia e shpërblimit nuk kufizohet , por nuk mund të jetë më e vogël se ajo e përcaktuar në aktin ligjor.

Neni 24

**Struktura juridike dhe organizimi dhe drejtimi administrativ**

Organi vendimor i shoqërisë është asamblea ku marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote. Ajo vendos bilancin vjetor për ndryshimin në statut, për shtimin apo pakësimin e kapitalit bazë të shoqërisë. Ajo vendos për derdhjen e shumave suplementare me kapitalin themelor, për emërimin e këshillit administrativ, për emërimin e komisionit të revizionimit, për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë etj. Unanimiteti në vendimin e Asamblesë së shoqërisë është i domosdoshëm:

a. Për ndryshimin në aktin e krijimit të statutit.

b. Për rritjen apo pakësimin e kapitalit bazë e për derdhjen e shumave suplementare në kapitalin themelor.

c. Zgjatjen e afatit të veprimtarisë së shoqërisë, parashikuar në aktin e themelimit të ortakërisë.

d. Për pushimin e veprimtarisë së ortakërisë.

Për çështjet e tjera asamblea vendos me shumicë votash.

Neni 25

Vendimet e marra nga asamblea sipas statutit janë të detyrueshme për pjesën e ortakëve që kanë votuar ndryshe.

Neni 26

Asamblea mbledhjet e saj i organizon me nismën e këshillit administrativ. Mbledhja e asamblesë zhvillohet kur merr pjesë më shumë se gjysma e ortakëve, këshilli administrativ dhe sindikata.

Neni 27

Mbledhja e asamblesë duhet të bëhet të paktën 2 herë në vit. Ndërsa për nevoja të ngutshme për ndryshimin e statusit, aktit të krijimit, ku do të diskutohet për riorganizimin e shoqërisë dhe ajo zhvillohet kur ta lypë nevoja.

Neni 28

Asamblea kryesohet nga Administratori unik, dhe kur ai mungon nga zëvendësadministratorët

Neni 29

Vendimet e marra në asamble evidentohen në procesverbalin e mbajtur i cili nënshkruhet nga administratori i shoqërisë.

Neni 30

Shoqëria drejtohet nga këshilli administrativ i përbërë nga tre pjesëtarë, njëri prej të cilëve do të zgjidhet administratori i shoqërisë . Këta në këto detyra vazhdojnë për tre vjet.

Neni 31

Këshilli administrativ ka kompetencë të plotë për drejtimin e shoqërisë duke i përpiluar të gjitha dokumentet e realizuara, të gjithë detyrat që janë në kompetencat e tij , me përjashtim të atyre që janë në kompetencë të asamblesë.

Neni 32

Këshilli administrativ thirret në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme me kërkesë të administratorit unik, kur përcaktohet vendi e koha, problemet që do të shqyrtohen etj. Në mungesë të administratorit unik këtë të drejtë e kanë zëvendësadministratorët. Vendimet e marra në këshillin administrativ janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë ortakët.

Neni 33

E drejta e shoqërisë dhe e përfaqësuesit të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe në gjykatë e arbitrazh dhe në organe të tjera i përket administratorit dhe zëvendësit dhe në mungesë të tyre një person tjetër i pajisur me prokurë të posaçme nga administratori, i cili ka të drejtën ekskluzive të delegimit. Për veprimet bankare, për nënshkrim çeqesh, e letrave me vlerë, veprohet nga administratori unik apo zëvendësi që kanë nënshkrime të depozituara ,në mungesë vepron i deleguari dhe gjithmonë kur vlera e autorizuar që tërhiqet nuk kalon shumën 10000 (dhjetëmijë) lekë.

Neni 34

Për të kontrolluar veprimtarinë e shoqërisë nga ana financiare dhe të filialeve të saj, zgjidhet komisioni i revizionimit kontabël, kompetencë kjo e asamblesë.

Librat e shoqërisë, bilanci, shpërblimi

Neni 35

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël ose librave të tjerë edhe këto libra:

- Libri i administratorit, në të cilin do të shënohet emri dhe kuota e tij.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit vendimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit administrativ.

Neni 36

**Shkrirja dhe likuidimi i shoqërisë**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të caktuar në aktin e krijimit ose më parë, kur kjo vendoset nga asambleja si për rastet kur nuk është rentabël, falimenton në pikëpamjen financiare, largohen ortakët etj.

Shoqëria ekzistuese mund të shpërndahet kur riorganizohet ose likuidohet për shkaqet e përmendura.

Neni 37

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Pas kryerjes së këtij procesi caktohen një ose disa likuidues të cilët paraqesin në Asamble gjendjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm. Në fund të procesit të likuidimit Asamblea vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbledhjen e procesit të likuidimit.

Neni 38

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve do të tentohen të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të paraqiten gjykatës kompetente shqiptare konform legjislacionit shqiptar.

Neni 39

Kur pushon së vepruari ortakëria e organizuar në shoqëri private, automatikisht e pushojnë aktivitetin e tyre dhe filialet e krijuara brenda dhe jashtë vendit.

Ky statut pasi lexohet nga të gjithë ortakët, miratohet kundrejt nënshkrimit.

**O R T A K Ë T**

| | | |
|---|---|---|
| **Mehmet Kastrati** | **Nazmi Dauti** | **Gëzim Cura** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
N O T E R I A

Tiranë, më 19.01.1994

Nr.526 Rep.
Nr.115 Kol.

# V Ë R T E T I M

Sot më datën ______ 1994 në Zyrën e Noterisë në Tiranë, përpara meje Noteres, m'u paraqitën personalisht:

1. Nazmi Dauti me numër letërnjoftimi Q.H. Nr.290201

2. Mehmet Kastrati me numër letërnjoftimi E.V. Nr.204620

3. Gëzim Curra me numër letërnjoftimi Q.H. Nr.483904

të cilët më deklaruan se sa sipër është akti i themelimit dhe Statutit i SHPK "Progres" i hartuar me vullnet të lirë dhe e nënshkruajnë në Noteri.

Unë Noterji e vërttoj rregullisht.

N O T E R I
Andon Pano

# URDHER REGJISTRIMI

Me 2

2.a........—........................................................................

b. ......—..........................................................................

c. ......—..........................................................................

.................................................................................

.................................................................................

.................................................................................

ç. ......—..........................................................................

3. —

4. Statuti nenshkruar me date
vendimi nr 1 dt. 12.I.1996 i asamblese
5. Data 12 I 1996

Statuti X Flete

Njoftime: a. shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime: X

GJYQTARE

# K E R K E S E

K E R K U E S I : Nazmi Dauti,i biri i Abdullait,i datelindjes 1940, banues ne Tirane ,me cilesine e administratorit te shoqerise "PROGRES"sh.p.k .

O B J E K T I : Depozitimin prane kesaj gjykate te vendimit te Asambleses se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "PROGRES"sh.p.k ,ne te cilin behet fjale per ndryshimet e meposhteme.

P E R P A R A : G J Y K A T E S S E R R E T H I T T I R A N E

Me vendimin e dates 8.1.1996 te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "PROGRES"sh.p.k ,eshte vendosur qe per aresye objektive te largohen nga kjo shoqeri dy ortaket e saj Nazmi Dauti dhe Mehmet Kasrati te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ia shesin kuotat e tyre te kapitalit themeltar perkatesisht prej 34.000 lekesh dhe 33.000 lekesh ( 34% dhe 33%) ,ortakut tjeter te shoqerise Gezim Curre ,i cili ka pranuar ti bleje ato duke u bere prohar i te gjithe kapitalit te kesaj shoqerie,qe eshte 100.000 leke.-----------------------

- Ndryshimi i selise se shoqerise "PROGRES"sh.p.k,nga selia e [illegible] ne Tirane ne rr."Mehmet Bega" nr.4,ne seline e re ne Perrenjas ne lagjen nr.1 ,pall.22.

- Ndryshimin e administratorit te kesaj shoqerie nga administratori aktual Nazmi Dauti ne emerimin e administratorit te ri Gezim Curra.

Bashkengjitur ketij,vendimi te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "Progres" sh.p.k ,kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit themeltar se bashku me kerkesen ,te cilat do te depozitohen ne [illegible].

Kjo shoqeri eshte e regjistruar ne Gjykate me dt.21.1.199[illegible] dhe me [illegible] te vendimit 1017.

Prandaj kerkojme prane kesaj gjykate qe ne baze te ligjeve [illegible] te beje ndryshimet e mesiperme.

Te depozitohen aktet.
Dt. 12.I.1996
[illegible]

K E R K U E S I
ADMINISTRATORI I SHOQ[illegible]
"PROGRES" SH.P.K
NAZMI DAUTI
[signature]

<u>K E R K E S E</u>

K E R K U E S : Nazmi Dauti, i biri i Abdullait dhe i Dudies, i datelindjes 11.7.1966, lindur ne Peshkopi dhe banues ne Tirane, me cilesine e shoqerise me pwrgjegjesi te kufizuar . "Progres "sh.p.k me qender ne Tirane rr."Mehmet Dega ", nr 4.

O B J E K T I : Depozitimin prane kesaj gjykate te vendimit te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "PROGRES"sh.p.k , ku behet fjale per prishjen dhe likuidimin e kesaj shoqerie .

P E R P A R A : G J Y K A T E S S E R R E T H I T <u>T I R A N E</u>

Parashtroj kerkesen time sa me poshte :
Me vendimin e dates 27.11. 1995, te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "Progres"sh.p.k, eshte vendosur per aresye objektive nga ortaket e kesaj shoqerie me kapital perkatesisht Nazmi Dauti me 33%, Mehmet Kastrati me 34% dhe Gezim Cuka me 33% te mbajtur ne Tirane ne seline e kesaj shoqerie ne rr.Mehmet Bega" nr. 4 , prishja e shoqerise se siperpermendur dhe likuidimi i saj si dhe caktimi i likuidatorit z.Robert Mancellari.

Kjo shoqeri eshte e regjistruar ne gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr.1017 te dates 21.1.1994.

Duke mos pasur rezultate dhene baze te vertetimit te leshuar nga zara e tatimeve te sektorit Nr.1 te dates 28.5.1995, dhe te vendimit te asamblese se shoqerise sone kerkojme nga ana e juaj qe te vendoset prishja dhe kikuidimi i shoqerise "Progres"sh.p.k si person juridik.

K E R K U E S I
ADMINISTRATORI NAZMI DAUTI
Dauti

Qe depozitohet kerkesa
dt 01.XII.1995
[illegible]

FIRMA "Progres"
dt. krij. 21. 1. 1994
Themel. Nazmi Dauti M. Kasnaci G. Cura.

# Depozitim

"Progres"

① HERË DEPOZITIMI: dt ___ gj 1017

② Kërkesë: KËRKUESI: Naxmi Dauti dt ___

NR Rep 301 NR kol. ___

a) ① largimi ortaku N. Dauti M. Kasnaci
b) ② Ndarje kuotash 34% e 33%.
c) ③ ≠ e Selisë nga Tirana në Preza
④ ≠ administratori nga N. Dauti në G. Cura.

③ Vendim Asambleje: dt 8.1.1996

NR Rep 300 NR kol 45

ortaki vetëm ___

Ortakët: Nazmi Dauti, Mehmet Kasnaci, Gezim Cura.

③ Kontratë shitje kuotash: dt 12.1.1996 NR Rep 328

SHITËSI: M. Kasnaci / N. Dauti % NR kol 53

BLERËSI: Gezim Curra. %

④ Vendim i gjyqtarit të vetëm: dt 12.1.1995

NR 1017/1

GJ. Florina Tepy

⑤ NR i depozitimit në libër: 1795

Tiranë më: 25/1/1996

Tirane, më 21.1.1994

(1017)

K E R K E S E

PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Kërkues: Nazmi Dauti , i biri i Avdullait, dt.1940, me banim në Tirane, Rr" Qemal Stafa" pall.587, shk.3, ap.7
Mehmet Kastrati, i biri i Shaqirit, dt.1932, me banim në Tirane, Rr" Mehmet Pega" Nr. 4
Gëzim Cura, i biri i Avdullait, dt.1960, me banim në adresën e mësipërme

Objekti: Kërkojmë të rregjistrojmë SHPK "Progres" si person juridik
Në baze të ligjës Nr. 7667 date 28.1.1993

GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E

Për interesat tona private kërkojmë të rregjistrojmë shoqërine tone SHPK "Progres" si person juridik.
Aktiviteti që do të zhvillojmë ne është:

Punime dheu, murature betoni, ndertime civile, industriale turistike bujqësore, instalime në to, punime restaurimi, transport brenda dhe jashtë vendit, makine, pjesë këmbimi etj me shumicë e pakicë import eksport.

Për këtë kërkojmë:

Rregjistrimin si person juridik të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar SHPK Progres

Mandati bankar
Nr. 202/75
date 12.1.1994

Kërkues

NAZMI DAUTI MAHMET KASTRATI GEZIM CURA

Te regjistrohet
26.I.94